



DEMOCRACYPLUS

# ANALIZË E SHKURTËR

DYFISHIMI I POZITAVE NË SHËRBIMIN  
CIVIL SI REZULTAT I RISTRUKTURIMIT TË  
QEVERISË: CILA ËSHTË ZGJIDHJA?

SHKURT 2020





# **ANALIZË E SHKURTËR**

DYFISHIMI I POZITAVE NË SHËRBIMIN  
CIVIL SI REZULTAT I RISTRUKTURIMIT TË  
QEVERISË: CILA ËSHTË ZGJIDHJA?

Përgatitur nga: **Visar Rushiti**

Design and Layout: **Envinion**

E drejta e autorit © 2020. Demokraci Plus (D+)

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, ruhet apo transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjetei elektronik, mekanik, fotokopjohet apo të tjera, pa lejen e D+.

Ky publikim është përkrahur nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Qëndrimet e shprehura këtu jo domosdoshmërisht paraqesin edhe ato të KFOS.

# Përmbajtja

<b>PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>6</b>
<b>DYFISHIMI I POZITAVE NGA INTEGRIMI I GJASHTË MINISTRIVE NË 15 MINISTRI....</b>	<b>7</b>
<b>MINISTRIA E EKONOMISË, PUNËS, TREGUT, INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE .....</b>	<b>9</b>
MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE (MPMS) .....	9
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRISË (MTI) .....	11
MINISTRIA E INOVACIONIT DHE NDËRMARRËSISË (MIN) .....	13
MINISTRIA E DIASPORËS DHE INVESTIMEVE STRATEGJIKE (MDIS) .....	14
<b>MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE (MPBAP) .</b>	<b>15</b>
MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE (MAP) .....	15
<b>MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE MJEDISIT (MIF) .....</b>	<b>17</b>
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR (MMPH) .....	17
<b>MINIMUMI I POZITAVE NGA GJASHTË MINISTRITË QË KRIJOJNË DYFISHIM .....</b>	<b>19</b>
<b>RRUGA PËRPARA .....</b>	<b>21</b>
OPSIONI 1.....	22
OPSIONI 2.....	22
<b>REKOMANDIME .....</b>	<b>24</b>

## Përmbledhje

- Në bazë të përbërjes së kabinetit qeveritar i votuar në Kuvend në fillim të shkurtit 2020, kemi të bëjmë me bashkim të ministrive apo pjesëve të tyre në ministri tjera por jo shuarje (suprimim) të ministrive. Kjo sepse dikasteret ministrore (apo pjesë të tyre) vetëm janë bartur në ministri që janë vlerësuar se kanë kuptim më shumë të jenë kështu se sa si kanë ekzistuar në të kaluarën;
- Ligji që mbulon fushën e shërbimit civil (qoftë Ligji për shërbimin civil qoftë Ligji për zyrtarët publik) e rregullon risistemimin e nëpunësve civil që klasifikohen tepricë si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së një institucioni;
- Sipas Ligjit për shërbimin civil, risistemimi ka dy afate: një muaj për risistemim në një pozitë ekuivalente (nëse ka të tillë) dhe deri në një vit për një ricaktim në një pozitë tjetër në kuadër të shërbimit civil;
- Sipas Ligjit për zyrtarët publik, risistemimi nuk ka afate dhe duhet të ndodhë brenda të njëjtës kategori (jo domosdo në pozitën e njejtë). Për këtë, krijohet një komision ristrukturimi i cili drejtohet nga njësia e pranimit (njësia e personelit) të institucionit përkatës dhe përbëhet nga përfaqësues të ministrive ose organeve që shërbejnë si alternativa për risistemim;
- Mënyra dhe procedura e risistemimit të nëpunësve civil të klasifikuar tepricë është e varur se cili ligj do të mbulojë shërbimin civil, Ligji për shërbimin civil apo Ligji për zyrtarët publik i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese deri më 28 shkurt 2020;
- Katër nga gjashtë ministritë që bashkohen me ministri tjera, bashkohen si tërësi në ministrinë amë kurse dy tjera ndahen në dysh: Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike dhe Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Në total, minimumi janë rreth 100 pozita në gjashtë ministri të cilat krijojnë dyfishime me pozita të njëjta në ministritë amë dhe kryesisht janë të nivelit drejtues;
- Ministritë që bashkohen si tërësi (pra nuk ndahen në mes dy ministrive) kanë mundësinë e risistemimit më të lehtë dhe uniform dhe sistemimi bëhet rast pas rasti i cili më së shumti mund të jetë ulje në pozitë të nëpunësit me pozitën e njejtë në ministrinë amë. Në anën tjetër, ministritë që ndahen në dysh sidomos nëse ministritë amë integrojnë vetëm departamentet funksionale, sistemimi i nëpunësve civil mund të jetë i ndarë në më shumë se një ministri;
- Numrin më të vogël të nëpunësve civil tepricë që krijohen nga riorganizimi e kanë ministritë me portfolio të gjerë sepse sidomos pjesa e zyrtarëve të kategorisë profesionale sistemo-hen lehtë për shkak të vëllimit të punëve që kanë ministritë që bashkohen;

# Dyfishimi i pozitave nga integrimi i gjashtë ministrive në 15 ministri

Numri i ministrive prej themelimit të Qeverisë së parë pas zgjedhjeve të para parlamentare të vitit 2001 në Kosovë ka qenë në rritje. Qeveria e kaluar e cila ka marrë mandatin në vitin 2017 ka trashëguar një Qeveri të përbërë me 19 ministri por ka shtuar numrin e ministrive duke krijuar edhe dy tjera dhe rritur numrin në 21: Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë. Po ashtu, Ministrisë së Diasporës i ishte shtuar edhe komponenta e Investimeve Strategjike. Në anën tjetër, edhe pse në fillim ishte premtuar një Qeveri me jo më shumë se 12 ministri, Qeveria e cila është votuar në Kuvend me 03 shkurt 2020 ka 15 ministri. Sipas kësaj, gjashtë ministri do të bashkohen me 15 ministrinë tjera sepse dikasteret qeveritare nuk janë shuar, por kemi të bëjmë vetëm me bashkime të ministrive me ministri aktuale.

Në këtë aspekt, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike ndahet në dysh, pjesa e diasporës bashkohet me Ministrinë e Punëve të Jashtme kurse pjesa e investimeve strategjike bashkohet me Ministrinë e Ekonomisë, Punës, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor i bashkohet Ministrisë së Infrastrukturës, Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë ndahet në dysh, pjesa e inovacionit i bashkohet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, kurse pjesa e Ndërmarrësisë i bashkohet Ministrisë së Ekonomisë, ku po ashtu bashkohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministria e Tregtisë

dhe Industrisë. Pra, ajo që ka ekzistuar si Ministri e Zhvillimit Ekonomik tani do të përbëhet nga tri ministri paraprake dhe dy komponentë apo pjesë të dy ministrive tjera dhe do të jetë ministria më e madhe me portfolio dhe numër të të punësuarve. Për fund, Ministria e Administratës Publike i bashkohet Ministrisë së Punëve të Brendshme në një emër si Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike.

Megjithatë, edhe pse ministrinë e cekura më lartë janë prezantuar si kabinet qeveritar (duke përfshirë edhe zyrën e Kryeministrit dhe dy zëvendës Kryeministrit), mandati i ministrive vazhdon të jetë i njëjti apo i pa definuar sipas formacionit të ri. Bashkimi i ministrive të cilat i kanë të përkrahura detyrat dhe përgjegjësitë në Rregullore për fushat e përgjegjësitë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive<sup>1</sup> patjetër se do të duhet të ndryshojë. Po ashtu, Rregulloret mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës për secilën ministri të prekur nga ristrukturimi i Qeverisë do të duhet të ndryshojnë. Po ashtu, të punësuarit në ministrinë që bashkohen me tjerat (ministrinë amë), nuk dihet se çfarë pozicioni do të kenë në formacionet e reja të ministrive dhe si do të sistematizohen një pjesë e stafit që krijojnë dyfishim me pozitave e njëjta në ministrinë amë. Tabela në vazhdim paraqet numrin e të punësuarve (shërbyes civil, publik dhe të emëruar) në gjashtë ministrinë të cilat integrohen në 15 ministrinë tjera.

1 Rregullore 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive: [shorturl.at/oL178](http://shorturl.at/oL178)

**TABELA 1: NUMRI I PËRGJITHSHËM (AKTUAL DHE I PLANIFIKUAR) I PUNËTORËVE  
NË GJASHTË MINISTRI**

Nr.	Ministria	Aktual	Planifikuar
1.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	794	855
2.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	225	248
3.	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	77	82
4.	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	27	52
5.	Ministria e Administratës Publike	266	277
6.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	323	343

BURIMI: RAPORTI VJETOR FINANCIAR 2018

Me qëllim të nxjerrjes së numrit të pozitave që krijojnë dyfishim në gjashtë ministritë përkatëse, janë analizuar rregulloret për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në secilën nga këto ministri. Edhe pse rregulloret në fjalë përfshijnë planifikim të stafit dhe nuk paraqesin numrin aktual/real të të punësuarve, në mungesë të të dhënave tjera, nxjerrja e pozitave është bërë duke u bazuar në këto rregullore. Në anën tjetër, kjo nuk ka qenë e vështirë pasi të gjitha ministritë (me ndonjë përjashtim të vogël) kanë tri departa

mente të cilat shkojnë me vet ekzistimin e ministrisë, si departamenti për financa dhe shërbime të përgjithshme, departamenti ligjor, departamenti për integritet evropian dhe tri divizione që janë me raportim te Sekretari i Përgjithshëm, përkatësisht Ministri. Në vijim është paraqitur ministria me emër sipas propozimit të kabinetit qeveritar në Kuvend me 03 shkurt 2020 dhe nën të është dhënë nga një elaborim për secilën ministri ose komponentë që bashkohet në ministrinë përkatëse. Po ashtu, nën të janë dhënë një minimum pozitash të cilat krijojnë dyfishim me pozitën përkatëse në ministrinë amë.



# Ministria e Ekonomisë, Punës, Tregut, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike

Ministria në fjalë përbëhet nga tri ministri paraprake, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) dhe dy komponentë të dy ministrive tjera, komponentën e ndërmarrësisë nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe komponentën e Investimeve Strategjike nga Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike. Për të analizuar se si dyfishohen ose shumëfishohen pozita të njejta të nëpunësve civil, më poshtë elaborohen pozita në departamente dhe struktura tjera që janë të njëjta me ato në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (MZHE). Pra, në këtë rast MZHE merret si ministria ombrellë ku i bije që të integrohen dy ministri dhe dy komponentë të dy ministrive tjera, pra shërben si pikë referente për të nxjerrur dyfishimi/shumëfishimin e pozitave të nëpunësve civil.

## Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

MPMS me gjithë organet qendrore dhe lokale në varësi të saj ka pasur 794 të punësuar në fund të

vitit 2018 sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave.<sup>2</sup> Mirëpo, sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MPMS,<sup>3</sup> vetëm në zyrat e Ministrisë ka 470 të punësuar prej të cilëve kanë këtë ndarje: 404 lidhen me departamentet funksionale të cilat në një definim të ri të përgjegjësive të kësaj pjese në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë do të duhej të barteshin sipas këtyre funksioneve në ministrinë amë. Kjo sepse edhe ligjet në fuqi krijojnë obligime për këto departamente dhe njësi të cilat nuk lidhen vetëm për Rregulloren e Qeverisë për përgjegjësitë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.<sup>4</sup> Në anën tjetër, 66 të punësuar janë pjesë e tri departamenteve dhe divizioneve të cilat krijojnë dyfishim me departamentet e njëjtë në Ministri të Ekonomisë.

Numri prej 66 të punësuarve potencialisht krijon dyfishim me pozita të ngjashme në Ministri të Ekonomisë sepse kemi të bëjmë me tri departamente (nëntë divizione brenda tyre) të cilat janë të organizuara në secilën ministri (Departamenti për Integrime Evropiane dhe Koordinim të Politikave me 10 nëpunës, Departamenti Ligjor me 11 nëpunës dhe Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me 30 nëpunës). Këtij numri i shtohen edhe nëpunësit në strukturat si

<sup>2</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, f. 86: [shorturl.at/vAV02](http://shorturl.at/vAV02)

<sup>3</sup> Rregullore nr. 14/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale: [shorturl.at/hBCU2](http://shorturl.at/hBCU2)

<sup>4</sup> Rregullore 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.

Divizioni i Auditimit të Brendshëm me 3 nëpunës, Divizioni i Komunikimit Publik me 3 nëpunës, Divizioni i Prokurimit me 3 nëpunës dhe zyra e Sekretarit të Përgjithshëm me 3 nëpunës përfshirë pozitën e Sekretarit. Nëse për shkak të vëllimit të

punës, pjesa e zyrtarëve nga këto departamente dhe struktura mund të akomodohen në Ministri të Ekonomisë, prapë janë disa pozita zyrtare që krijojnë dyfishim dhe kërkojnë zgjidhje.

**TABELA 2: POZITAT DHE NUMRI I NËPUNËSVE ME KËTO POZITA QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Pozita në MPMS	Numri i pozitave
Sekretar i Përgjithshëm	1
Personeli në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm	2
Udhëheqës i divizionit të auditimit të brendshëm	1
Udhëheqës i divizionit të komunikimit publik	1
Udhëheqës i divizionit të prokurimit	1
Drejtor i departamentit për integritet evropian dhe koordinim të politikave	1
Udhëheqës i divizionit për integritet evropian	1
Udhëheqës i divizionit për koordinim të politikave	1
Drejtor i Departamentit ligjor	1
Udhëheqës i divizionit për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për shqyrtimin e parashtresave dhe ankesave	1
Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	1
Udhëheqës i divizionit për burime njerëzore	1
Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	1
Udhëheqës i divizionit të IT-së dhe shërbimeve logjistike	1
<b>Total</b>	<b>17</b>

## Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

MTI me gjithë organet qendrore në varësi të saj ka pasur 225 të punësuar në fund të vitit 2018 sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave.<sup>5</sup> Mirëpo, sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MTI,<sup>6</sup> vetëm në zyrat e Ministrisë me organet qendrore ka 198 të punësuar prej të cilëve kanë këtë ndarje: 147 lidhen me departamentet funksionale të cilat në një definim të ri të përgjegjësive të kësaj pjese në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë do të duhej të barteshin sipas këtyre funksioneve në ministrinë amë. Kjo sepse edhe ligjet në fuqi krijojnë obligime për këto departamente dhe njësi të cilat nuk lidhen vetëm për Rregulloren e Qeverisë për përgjegjësitë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive. Në anën tjetër, 51 të punësuar janë pjesë e tri departamenteve të cilat krijojnë dyfishim me departamentet e njëjta në Ministri të Ekonomisë.

Numri prej 51 të punësuarve potencialisht krijojnë dyfishim me pozita të ngjashme në Ministri të Ekonomisë sepse kemi të bëjmë me tri departamente (10 divizione brenda tyre) të cilat janë të organizuara në secilën ministri (Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave me 5 nëpunës, Departamenti Ligjor me 6 nëpunës dhe Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme me 28 nëpunës). Në këtë numër shtohen edhe zyrtarët në strukturat si Divizioni i Auditimit të Brendshëm me 2 nëpunës, Divizioni i Komunikimit Publik me 3 nëpunës, Divizioni i Prokurimit me 4 nëpunës dhe zyra e Sekretarit të Përgjithshëm me 3 nëpunës përfshirë pozitën

e Sekretarit. Nëse edhe në këtë rast për shkak të vëllimit të punës, pjesa e zyrtarëve të departamenteve dhe strukturave përkatëse në MTI mund të akomodohen në Ministri të Ekonomisë, prapëseprapë janë disa pozita zyrtare që krijojnë dyfishim dhe kërkojnë zgjidhje.



**MPMS me gjithë organet qendrore dhe lokale në varësi të saj ka pasur 794 të punësuar në fund të vitit 2018 sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave.**

<sup>5</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, f. 86.

<sup>6</sup> Rregullore nr. 29/2012 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë: [shorturl.at/oHVZ9](http://shorturl.at/oHVZ9) dhe Rregullore nr. 10/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e kësaj rregulloreje: [shorturl.at/ELVYZ](http://shorturl.at/ELVYZ)

**TABELA 3: POZITAT DHE NUMRI I NËPUNËSVE ME KËTO POZITA QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Pozita në MTI	Numri i pozitave
Sekretar i Përgjithshëm	1
Personeli në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm	2
Udhëheqës i divizionit të auditimit të brendshëm	1
Udhëheqës i divizionit të komunikimit publik	1
Udhëheqës i divizionit të prokurimit publik	1
Drejtor i departamentit për integrimë evropiane dhe koordinim të politikave	1
Udhëheqës i divizionit për integrimë evropiane	1
Udhëheqës i divizionit për koordinim të politikave	1
Drejtor i departamentit ligjor	1
Udhëheqës i divizionit për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	1
Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	1
Udhëheqës i divizionit për burime njerëzore	1
Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	1
Udhëheqës i divizionit të IT-së dhe shërbimeve logjistike	1
<b>Total</b>	<b>16</b>

## Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë (MIN)

MIN ka pasur 27 të punësuar në fund të vitit 2018 sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave.<sup>7</sup> MIN është ndarë në dysh, në komponentën e inovacionit e cila integrohet në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë kurse komponenta e ndërmarrësisë integrohet në Ministrinë e Ekonomisë. Nëse Ministria e Arsimit integron

vetëm komponentën e inovacionit (departamenti për inovacion me shtatë të punësuar) kurse Ministria e Ekonomisë vetëm komponentën e ndërmarrësisë (departamenti i ndërmarrësisë me shtatë të punësuar), atëherë dy departamente (departamenti ligjor dhe departamenti për financa dhe shërbime të përgjithshme)<sup>8</sup>, përkatësisht punëtorët e tyre do të duhej të sistemoheshin në një ministri përkatëse.<sup>9</sup>

**TABELA 4: POZITAT DHE NUMRI I NËPUNËSVE ME KËTO POZITA QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Pozita në MIN	Numri i pozitave
Sekretar i Përgjithshëm	1
Personeli në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm	1
Drejtor i departamentit ligjor	1
Udhëheqës i divizionit për hartimin dhe harmonizimin e legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	1
Zyrtar në departamentin ligjor	4
Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	1
Udhëheqës i divizionit për burime njerëzore	1
Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	1
Udhëheqës i divizionit të IT-së dhe shërbimeve logjistike	1
Zyrtar në departamentin për financa dhe shërbime të përgjithshme	4
<b>Total</b>	<b>17</b>

<sup>7</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, f. 86.

<sup>8</sup> Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë nuk ka departament për integritet evropian dhe koordinim të politikave.

<sup>9</sup> Rregullore nr. 23/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë: [shorturl.at/goqë3](http://shorturl.at/goqë3)

## Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike (MDIS)

MDIS ka pasur 77 të punësuar në fund të vitit 2018 sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave.<sup>10</sup> Kjo ministri po ashtu ndahet në dysh, komponenta e diasporës integrohet në Ministrinë e Punëve të Jashtme kurse komponenta e investimeve strategjike integrohet në Ministrinë e Ekonomisë. Nëse të dy ministritë që marrin nga një komponentë do të integrojnë vetëm departa-

mentet funksionale (MDIS ka tri departamente që lidhen me komponentën e diasporës dhe një departament për investime strategjike), atëherë janë 23 të punësuar tjerë të cilët janë pjesë e departamentit ligjor dhe divizioneve në kuadër të departamentit, departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme dhe divizioneve në kuadër të departamentit<sup>11</sup> dhe tri divizioneve në varësi të ministrit dhe sekretarit të përgjithshëm (divizioni i auditimit të brendshëm, i prokurimit publik dhe divizioni i komunikimit me publikun).<sup>12</sup>

**TABELA 5: POZITAT DHE NUMRI I NËPUNËSVE ME KËTO POZITA QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Pozita në MDIS	Numri i pozitave
Sekretar i Përgjithshëm	1
Drejtor i departamentit ligjor	1
Udhëheqës i divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	1
Zyrtar në departamentin ligjor	2
Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	1
Udhëheqës i divizionit për burime njerëzore	1
Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	1
Udhëheqës i divizionit të IT-së dhe shërbimeve logjistike	1
Zyrtar në departamentin e financave dhe shërbime të përgjithshme	13
<b>Total</b>	<b>23</b>

10 Ministria e Financave, Raporti vjetor për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, f. 86.

11 MDIS nuk ka departament për integrimet evropiane dhe koordinim të politikave.

12 Rregullore nr. 03/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike: [shorturl.at/gpNRO](http://shorturl.at/gpNRO)

# Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP)

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike përbëhet nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administratës Publike. Sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave, MPB me gjithë numrin e të punësuarve në organet qendrore dhe degët lokale të tyre, ka pasur 9,894 të punësuar në fund të vitit 2018.<sup>13</sup> MPB ka tri departamente të cilat janë të njejtë pothuajse në secilën ministri dhe divizionet me raportim të Ministri, përkatësisht Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë.

menti ligjor, departamenti për integritet evropian dhe koordinim të politikave, divizioni i prokurimit, divizioni për komunikim publik dhe divizioni i auditimit të brendshëm. Mirëpo, meqenëse të dy ministrinë, MPB dhe MAP, janë ministri me portfolio të gjerë dhe me numër të madh të punësuarve, për shkak të vëllimit të punëve, pjesa e zyrtarëve nuk krijon dyfishim të pozitave me MPB me përjashtim të 12 pozitave që janë drejtuese. Kjo do të thotë se nga numri prej 69, vetëm 12 pozita janë drejtuese të cilat do të mund prapëseprapë të sistemoheshin në ministrinë me organizim të ri vetëm se në një pozitë tjetër nga ajo aktuale.

## Ministria e Administratës Publike (MAP)

Sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave, MAP ka pasur 266 të punësuar në fund të vitit 2018 kurse të planifikuar dhe të paraparë përmes Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MAP janë 277.<sup>14</sup> Ky numër përfshinë edhe dy organet qendrore apo agjencitë ekzekutive në kuadër të MAP, Institutin e Kosovës për Administratë Publike (IKAP) dhe Agjencinë e Shoqërisë së Informacionit (ASHI). Sipas Rregullores në fjalë dhe organogramit të bashkëngjitur, janë 69 të punësuar të cilët janë të sistemuar në departamentet dhe divizionet të cilat ekzistojnë në MPB si: departamenti i financave dhe shërbimeve të përgjithshme, departa-

<sup>13</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, f. 86.

<sup>14</sup> Rregullore nr. 02/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Administratës Publike (MAP): [shorturl.at/ksJMO](http://shorturl.at/ksJMO)

**TABELA 6: POZITAT DHE NUMRI I NËPUNËSVE ME KËTO POZITA QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Pozita në MAP	Numri i pozitave
Sekretar i Përgjithshëm	1
Drejtor i departamentit ligjor	1
Udhëheqës i divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	1
Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	1
Udhëheqës i divizionit të burimeve njerëzore	1
Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	1
Udhëheqës i divizionit për TI dhe shërbime logjistike	1
Udhëheqës i divizionit për komunikim publik	1
Udhëheqës i divizionit të auditimit të brendshëm	1
Udhëheqës i divizionit të prokurimit	1
Udhëheqës i divizionit për integritet evropiane dhe koordinim të politikave	1
<b>Total</b>	<b>12</b>



## Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit (MIF)

Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit përbëhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas raportit vjetor të Ministrisë së Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka pasur 281 të punësuar në fund të vitit 2018.<sup>15</sup> Sikurse edhe ministritë tjera, edhe Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka departamentet dhe divizionet të cilat krijojnë dyfishim si strukturë dhe si pozita të punës në krahasim me ministritë tjera, në këtë rast me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

divizioni për integritet evropian dhe koordinim të politikave, divizioni i prokurimit, divizioni për komunikim publik dhe divizioni i auditimit të brendshëm. Mirëpo, meqenëse të dy ministritë, MMPH dhe MIT, janë ministri me portfolio të gjerë dhe me numër të madh të punësuarve, për shkak të vëllimit të punëve, pjesa e zyrtarëve nuk krijon dyfishim të pozitave me ministrinë amë me përjashtim të 15 pozitave që janë drejtuese.

## Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)

Sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave, MMPH ka pasur 323 të punësuar në fund të vitit 2018, kurse sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në MMPH janë 224 të punësuar.<sup>16</sup> Ky numër përfshinë edhe dy organet qendrore apo agjencitë ekzekutive në kuadër të MMPH, Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK). Sipas rregullores në fjalë dhe organogramit të bashkëngjitur, janë 91 të punësuar të cilët janë të sistemuar në departamentet dhe divizionet të cilat ekzistojnë në Ministri të Infrastrukturës dhe Transportit (MIT) si: departamenti i financave dhe shërbimeve të përgjithshme, departamenti ligjor,



Sipas raportit vjetor financiar të Ministrisë së Financave, MMPH ka pasur 323 të punësuar në fund të vitit 2018.

<sup>15</sup> Ministria e Financave, Raporti vjetor për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2018, f. 86.

<sup>16</sup> Rregullore nr. 05/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH): [shorturl.at/mrxJ5](http://shorturl.at/mrxJ5)

**TABELA 7: POZITAT DHE NUMRI I NËPUNËSVE ME KËTO POZITA QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Pozita në MMPH	Numri i pozitave
Sekretar i Përgjithshëm	1
Drejtor i departamentit ligjor	1
Udhëheqës i divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislacionit	1
Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit	1
Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	1
Udhëheqës i divizionit të burimeve njerëzore	1
Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	1
Udhëheqës i divizionit për TI dhe shërbime logjistike	1
Drejtor i departamentit për integritet evropian dhe koordinim të politikave	1
Udhëheqës i divizionit për integritet evropian	1
Udhëheqës i divizionit për koordinim të politikave	1
Udhëheqës i divizionit për komunikim publik	1
Udhëheqës i divizionit të auditimit të brendshëm	1
Udhëheqës i divizionit të prokurimit	1
<b>Total</b>	<b>15</b>

## Minimumi i pozitave nga gjashtë ministritë që krijojnë dyfishim

Duke u bazuar në elaborimin e ministrive si më sipër, ekziston një numër minimum i pozitave që dalin si dyfishim (madje edhe shumëfishim në rastin e Ministrisë së Ekonomisë) nga ekzistimi i disa departamenteve dhe divizioneve të njëjta në secilën ministri. Këto pozita janë kryesisht drejtuese sepse në shumicën e rasteve nëpunësit civil apo zyrtarët në këto ministri mund të sistemohen për shkak të vëllimit të punëve. Mirëpo, për ministritë që ndahen në dysh, nuk mund të përdoret e njëjta analogji sepse me ndarjen e Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në mes të Minis-

trisë së Arsimit dhe Ministrisë së Ekonomisë, duke integruar në to departamentet funksionale (që lidhen me inovacion dhe ndërmarrësi), del që pjesa e departamenteve tjera të mbetet në mes dhe pa një adresë. Kjo do të thotë që njëra ministri, si për shembull, Ministria e Arsimit, të integrojë edhe pjesën e departamenteve tjera meqenëse është një prej ministrive e cila nuk është e ngarkuar me bashkime të ministrive tjera në këtë ministri. Tabela në vazhdim paraqet minimumin e pozitave nga gjashtë ministritë që potencialisht krijojnë dyfishim me pozitat e njëjta në ministritë amë.

**TABELA 8: MINIMUMI I POZITAVE NË GJASHTË MINISTRI QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Nr.	Ministria	Pozita të dyfishuara
1.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	17
2.	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	16
3.	Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike	23
4.	Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë	17
5.	Ministria e Administratës Publike	12
6.	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	15
<b>Total</b>		<b>100</b>

Nëse këto pozita i ndajmë sipas titujve, për shembull, sekretar, drejtor të departamenteve përkatëse, personel në zyrën e Sekretarit dhe të tjera pozita, atëherë kemi të bëjmë me ndarjen si më poshtë:

**TABELA 9: NNDARJA E POZITAVE SIPAS TITUJVE NË GJASHTË MINISTRITË QË KRIJOJNË DYFISHIM**

Nr.	Pozitat sipas titujve	Nr i pozitave
1.	Sekretar i Përgjithshëm	6
2.	Drejtor i departamentit ligjor	6
3.	Drejtor i departamentit për financa dhe shërbime të përgjithshme	6
4.	Drejtor i departamentit për integritet evropian dhe koordinim të politikave	4
5.	Udhëheqës i divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislativës	6
6.	Udhëheqës i divizionit për mbikëqyrje të zbatimit të legjislativës	6
7.	Udhëheqës i divizionit të burimeve njerëzore	6
8.	Udhëheqës i divizionit për buxhet dhe financa	6
9.	Udhëheqës i divizionit për TI dhe shërbime logjistike	6
10.	Udhëheqës i divizionit për integritet evropian	4
11.	Udhëheqës i divizionit për koordinim të politikave	4
12.	Udhëheqës i divizionit për auditim të brendshëm	6
13.	Udhëheqës i divizionit për komunikim publik	6
14.	Udhëheqës i divizionit për prokurim	6
15.	Zyrtar në departamentin ligjor	6
16.	Zyrtar në departamentin për financa dhe shërbime të përgjithshme	16
<b>Total</b>		<b>100</b>

## Rruga përpara

Siç është thënë edhe më lartë, riorganizimi i Qeverisë në mënyrën se si është votuar kabineti qeveritar në Kuvend, nuk nënkupton shuarje (sprimim) të ndonjë ministrie apo organizate por bashkim të ministrive apo pjesëve të ministrive me ministri tjera amë. D.m.th porfoliot që kanë pasur gjatë ministritë që bashkohen me ministritë tjera nuk janë shuar, por vetëm akomodohen në ministri amë. Mirëpo, Qeveria nuk duhet ta mendojë riorganizimin e Qeverisë në pjesë të ndara në kuptimin që kemi një bashkim të disa ministrive rreth një ministrie por duhet të shihen funksionet si tërësi dhe nxjerrën detyra dhe përgjegjësi të reja për ministritë të cilat më vonë marrin edhe formën e organizimit. Për shembull, mund të ketë raste që një ministri e caktuar të bashkohet me një tjetër, por një pjesë e të parës të ketë rastin të jetë më afër bashkimit me një ministri tjetër. Për shembull, MPMS do të jetë si tërësi e bashkuar në Ministrinë e Ekonomisë, por nëse shihen detyrat që kryen sot, MPMS duke përfshirë ndarjen e subvencioneve në disa skema apo kategori, duhet menduar që funksione të caktuara të saj ndoshta më mirë lidhen me Ministrinë e Financave dhe Transfereve. Për këtë arsye, riorganizimin e Qeverisë duhet menduar në tërësi dhe jo pjesë-pjesë sipas disa ministrive sepse vetëm bashkimi i disa ministrive në një pa e shikuar problematikën në tërësi mund të çojë në organizime që më vonë më shumë do të prodhojnë dëm se sa të mira.



MPMS do të jetë si tërësi e bashkuar në Ministrinë e Ekonomisë, por nëse shihen detyrat që kryen sot, MPMS duke përfshirë ndarjen e subvencioneve në disa skema apo kategori, duhet menduar që funksione të caktuara të saj ndoshta më mirë lidhen me Ministrinë e Financave dhe Transfereve.

Sa i përket sistemimit të nëpunësve civil, një fakt që e bënë situatën të paktën për disa javë më komplekse apo të mjegullt është legjislacioni i zbatueshëm për shërbimin civil. Ligji për shërbimin civil është shfuqizuar që nga 12 shtatori 2019<sup>17</sup> për shkak të hyrjes në fuqi të Ligjit për zyrtarët publik<sup>18</sup> kurse ky i fundit i pezulluar nga 19 nëntori 2019 deri me 28 shkurt 2020<sup>19</sup>. Në këtë situatë, sipas vlerësimeve të juristëve, duhet të kthehet ligjit i

17 Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës: [shorturl.at/fimDI](http://shorturl.at/fimDI)

18 Ligji nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik: [shorturl.at/iktuz](http://shorturl.at/iktuz)

19 Gjykata Kushtetuese, vendimet nga seanca shqyrtuese e mbajtur më 19 nëntor 2019, vendimi 1 për masë të përkohshme (lënda 203/19): [shorturl.at/hsyU9](http://shorturl.at/hsyU9)

vjetër, pra Ligji për shërbimin civil. Pra, në këtë kohë, duhet vlerësuar situatën sipas dy ligjeve sepse deri me 28 shkurt vlen Ligji për shërbimin civil, kurse pas datës 28 shkurt varet nga akt gjykim i Gjykatës Kushtetuese dhe pritet që nëse jo në tërësi, Ligji për zyrtarët publik të kthehet në fuqi.

## Opsioni 1

Opsioni i parë lidhet me aplikimin e Ligjit për shërbimin civil sipas të cilit, nëpunësit civil të cilët janë tepricë pas bashkimit të ministrisë me një ministri tjetër, nëse ekzistojnë pozita ekuivalente, duhet të sistemohen në ato pozita. Mirëpo, nëse nuk ka pozita ekuivalente, atëherë sistemohen në pozita tjera dhe kryejnë trajnimin përkatës sipas pozitës ku është ri-caktuar.<sup>20</sup> D.m.th. në këtë rast mund të ndodhë ulje në pozitë në rast të risistemimit në një pozitë që nuk është ekuivalente me pozitën paraprake. Në anën tjetër, nëse nëpunësi civil refuzon të kryejë trajnimin me qëllim të risistemimit në një pozitë tjetër, kjo do të thotë që nëpunësi civil përfundon marrëdhënien e punës në shërbim civil. Për më shumë, gjatë kohës që nëpunësi civil është me status të nëpunësit civil tepricë, ka dy afate: afati i parë është një muaj për ricaktim në një pozitë ekuivalente, dhe afati i dytë është një vit gjatë të cilit pritet që nëpunësi civil të sistemohet në një institucion në pozitë tjetër.<sup>21</sup> Nëse kalon koha prej një viti dhe ende nuk është kryer sistemimi apo ricaktimi në një pozitë tjetër, nëpunësi civil përkatës e humb vendin e tij të punës në shërbimin civil.



Opsioni i parë lidhet me aplikimin e Ligjit për shërbimin civil sipas të cilit, nëpunësit civil të cilët janë tepricë pas bashkimit të ministrisë me një ministri tjetër, nëse ekzistojnë pozita ekuivalente, duhet të sistemohen në ato pozita.

## Opsioni 2

Opsioni dy lidhet me aplikimin e Ligjit për zyrtarët publik i cili po ashtu trajton transferimin e nëpunësit civil në rast të mbylljes apo rristrukturimit të ministrisë. Ky ligj e trajton këtë element më favorshëm për nëpunësin civil se sa Ligji për shërbimin civil. Sipas Ligjit për zyrtarët publik, nëpunësi civil transferohet në një pozitë tjetër brenda të së njëjtës kategori (megjithëse nuk do të thotë me pozitë të njëjtë), mirëpo në këtë ligj nuk bëhet fjalë për afate dhe mundësi të shkëputjes së marrëdhënies së punës pas kalimit të afatit për ricaktim. Pra, me rastin e bashkimit të ministrisë me ministrinë tjetër, nëpunësi civil në parim transferohet në ministrinë amë brenda kategorisë qoftë profesionale, qoftë drejtuese (drejtuese si-

20 Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Neni 32.

21 Rregullore nr. 08/2012 për Nëpunësit Civil Tepricë: [shorturl.at/emrz5](http://shorturl.at/emrz5)

pas niveleve) por nuk do të thotë që pozita është ekuivalente me atë më përpara. Nëse nuk është e mundur që nëpunësi civil të transferohet në ministrinë amë, ai/ajo mund të transferohet edhe në institucion tjetër të shërbimit civil dhe në çdo rast krijohet një komision ristrukturimi i cili drejtohet nga njësia e pranimit (njësia e personelit) dhe përbëhet nga përfaqësues sipas opsioneve ku mund të sistemohet nëpunësi civil (agjenci ekzekutive, institucion tjetër, ministrinë amë, etj). Çështja e risistemimit të nëpunësve civil, sipas Ligjit për zyrtarët publik, rregullohet në mënyrë të hollësishme me akt nënligjor të propozuar nga ministria përgjegjëse për administratë publike, mirëpo për shkak të pezullimit të vet Ligjit për zyrtarët publik, finalizimi dhe miratimi i akteve nënligjore që dalin nga ky ligj ka ngecur.

Lidhur me pozitat që në këtë punim janë nxjerre si dyfishim, pra janë dy situata varësisht se në cilin ligj që rregullon shërbimin civil do të ndërmerren hapat përkatës. Në Ligjin për shërbimin civil, nëpunësit civil të gjashtë ministrive që nga dita e miratimit të Qeverisë së re janë nëpunës civil tepriçë dhe brenda një muaji (sipas ligjit) duhet të sistemohen në pozita ekuivalente, nëse ekzistojnë pozita ekuivalente. Mirëpo, meqenëse kjo është e pamundur në shumicën e rasteve, do të kalohet në afatin deri një vit gjatë se cilës kohë pritet që nëpunësit civil të sistemohen në pozita tjera në ministrinë amë apo në institucione tjera të shërbimit civil. Në situatën ku Ligji për zyrtarët publik kthehet në fuqi pas një aktgjykimi të Gjykatës Kushtetuese, prap kemi të bëjmë me transferime të nëpunësve civil brenda kategorisë për ri-sistemim qoftë në ministrinë amë, agjenci ekzekutive të ministrisë amë, apo edhe në institucion tjetër të shërbimit civil. Mirëpo, siç është cekur edhe më lartë, ky ligj nuk përcakton afate për ri-caktim dhe nëse nuk arrihet afati apo mundë-

sia e tillë, nëpunësi civil të humb vendin e tij të punës pas një viti. Nëse kemi parasysh parimin e karrierës në shërbimin civil, atëherë ri-sistemimi i nëpunësve civil duke përfshirë edhe pozitat që krijojnë dyfishim, duhet të bëhet me Ligjin për zyrtarët publik.



Opsioni dy lidhet me aplikimin e Ligjit për zyrtarët publik i cili po ashtu trajton transferimin e nëpunësit civil në rast të mbylljes apo ristrukturimit të ministrisë.

## Rekomandime

Në bazë të elaborimit si më sipër, mund të jepen një numër i rekomandimeve kryesisht për Qeverinë në procesin e riorganizimit dhe risistemimit të nëpunësve civil:

- 1 Qeveria duhet ta shohë ristrukturimin e Qeverisë në tërësi dhe jo vetëm të ministrive që janë të prekura nga ristrukturimi i Qeverisë. Kjo sepse nëpunës civil mund të transferohen edhe në institucione tjera të shërbimit civil jashtë ministrive të prekura nga ri-organizimi dhe për këtë arsye duhet parë komplet problemin e organizimit dhe sistemimit dhe jo pjesërisht;
- 2 Për të pasur një mënyrë dhe procedurë për tërë procesin e risistemimit të nëpunësve civil, Qeveria duhet të presë aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese mbi Ligjin për zyrtarët publik i cili është pezulluar deri më 28 shkurt 2020;
- 3 Në rastin e kthimit në fuqi të Ligjit për zyrtarët publik, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike duhet të dërgojë për miratim në Qeveri aktet nënligjore të cilat rrjedhin nga Ligji për zyrtarët publik ku përfshihet edhe rregullimi i procedurës së hollësishme për risistemimin e nëpunësve civil dhe përbërjes së komisionit të ristrukturimit;
- 4 Qeveria duhet të hyjë në një proces të gjatë të ristrukturimit (si tërësi) dhe risistemimi të nëpunësve civil në tërë Qeverinë sepse ristrukturimi dhe risistemimi i mirëfilltë kërkojnë kohë dhe ekspertizë të cilat në fund prodhojnë organizim dhe sistemim të Qeverisë që në fund të fundit ofron shërbime në mënyrë profesionale për qytetarët;
- 5 Qeveria nuk duhet të hyjë në një cikël shkarkimesh vetëm për faktin se nëpunësit e shkarkuar janë tepërcë. Shërbimi civil në Kosovë është i bazuar në karrierë dhe kjo duhet të ruhet në vazhdimësi;
- 6 Qeveria nuk duhet të bëjë ulje të numrit të nëpunësve civil përmes riorganizimit. Në rast se Qeveria ka në objektive uljen e numrit të të punësuarve në shërbimin civil, duhet të ngrijë punësimin për një periudhë të caktuar deri në



risistemimin e plotë të nëpunësve civil aktualisht të punësuar në shërbimin civil dhe pastaj përmes rekrutimit të centralizuar për nivel të Qeverisë të vendoset një rregull mbi numrin dhe sistemimin e nëpunësve civil nëpër ministri;

- 7 Një numër i pozitive drejtuese (edhe të nivelit të lartë drejtues) mund të sistemohen në pozita ekuivalente nëse analizohet mirë situata ku ka mungesë të stafit. Për shembull, një Sekretar i Përgjithshëm mund të sistemohet në pozitën e Drejtorit të Përgjithshëm të agjencisë ekzekutive apo një drejtor departamenti i ministrisë të jetë drejtor departamenti i një agjencie ekzekutive në kuadër të ministrisë;
- 8 Po ashtu, me definimin e rolit dhe përgjegjësive të ministrive pas bashkimit, mund të krijohen departamente dhe divizione të reja të cilat janë pozita ekuivalente me pozitat aktuale drejtuese në ministrinë që janë subjekt i bashkimit;





Demokrasi Plus (D+) është një organizatë e pavarur dhe jofitimprurëse e themeluar në mars të vitit 2016. D+ është e përkushtuar për krijimin e një shoqërie demokratike përmes rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politike, rritjes së llogaridhënies dhe ndikimit në proceset e vendimmarrjes. Ne tentojmë integrimin e teknologjisë informative në të gjitha përpjekjet tona, kjo për të nxitur përdorimin e internetit, i cili ka rol të rëndësishëm në demokratizimin e një shoqërie.

D+ synon që të kontribuojë në krijimin e praktikave të mira për qeverisje të mirë nga institucionet publike në nivel qendror dhe lokal, fuqizimin e sundimit të ligjit, avancimin e partive politike, si dhe përkrahjen e proceseve të lira dhe të drejta zgjedhore.

Përkrahur nga:

